



# Llogaridhënia pa progres

**Analizë e (mos)zbatimit të Ligjit për Përgjegjësinë  
Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve**



**Nëntor, 2021**

Autor: Gzim Shala

Me kontribut të hulumtueses: Anesa Hoxha

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj, Betim Musliu dhe Qemajl Marmullakaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

*Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.*

*Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë”, i cili mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe zbatohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD në partneritet me Iniciativa për Progres – INPO.*

## RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rustem Statovci

Prishtinë

E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)

[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Përkrahur nga:

Nëntor, 2021

Prishtinë, Republika e Kosovës



**National Endowment  
for Democracy**  
*Supporting freedom around the world*

## Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	5
2. Trajtimi i rasteve disiplinore nga sistemi gjyqësor dhe prokurorial .....	7
2.1. Sistemi gjyqësor .....	7
2.2. Sistemi prokurorial.....	9
2.3. Institucioni i Avokatit të Popullit.....	12
3. Inicimi i procedurave disiplinore nga IKD.....	12
4. Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rasteve disiplinore nga sistemi prokurorial .....	12
5. Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rasteve disiplinore nga sistemi gjyqësor .....	14
6. Avokati i popullit përballë llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve.....	16
7. Heshtja e MD-së përballë nevojave të avancimit të ligjit.....	19
8. Rekomandime .....	21
9. Shtojca 1: Ankesat disiplinore të iniciuara nga IKD .....	22

## **Lista e shkurtesave**

AK	Autoriteti kompetent
BpD	Betimi për Drejtësi
GjA	Gjykata e Apelit
GjS	Gjykata Supreme
GjTh	Gjykata Themelore
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
LPDGjP	Ligji NR. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve
MD	Ministria e Drejtësisë
NjIGj	Njësia për Inspektim Gjyqësor
NjShPP	Njësia për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorëve
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PTh	Prokuroria Themelore

## 1. Përmbledhje ekzekutive

Mungesa e llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve është pengesa kryesore e avancimit të sistemit kosovar të drejtësisë drejt një sistemi llogaridhënës, me integritet dhe profesional. Duke njohur këtë rëndësi, Republika e Kosovës përmes LPDGjP ka reformuar këtë sistem të llogaridhënies. Por, mungesa e vullnetit për të zbatuar LPDGjP në mënyrë të drejtë, të pavarur, dhe të paanshme ka bërë që as ky sistem mos të jap rezultatet e kërkuara, duke ofruar amnisti për prokurorët dhe gjykatësit që veprojnë në kundërshtim me parimet e përcaktuara në këtë ligj.

Nga 276 ankesat disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët gjatë vitit 2020 dhe gjysmën e parë të vitit 2021 kanë hudhur poshtë gjithsej 233 ankesa disiplinore apo mbi 84.4% të ankesave disiplinore. Këto ankesa disiplinore janë hudhur pa shkuar fare në këshilla për hetim nga ana e paneleve hetimore. Edhe në ato pak raste të cilat kanë shkuar në këshillin përkatës për hetim, në vendimet disiplinore të KGJK-së dhe KPK-së, dominojnë vendimet ku kanë liruar gjyqtarët dhe prokurorët nga përgjegjësia disiplinore.

Nga 30 vendime disiplinore të nxjerra nga KGJK gjatë vitit 2020 dhe gjysmën e parë të vitit 2021, 19 prej tyre apo 63.3% janë vendime liruese, katër (4) vendime janë vërejtje publike dhe tri (3) vërejtje jo publike derisa në katër (4) raste të tjera, KGJK gjyqtarëve u ka shqiptuar masë disiplinore “zvogëlim të pagës”. Në rastin e sistemit prokurorial, KPK nga nëntë (9) vendimet disiplinore të nxjerra gjatë vitit 2020 dhe fillimit të vitit 2021, pesë (5) prej tyre apo 55.5% kanë qenë lirim nga përgjegjësia disiplinore, në tri (3) raste ka shqiptuar vërejtje jo-publike me shkrim derisa në një (1) rast ka shqiptuar masë disiplinore “zvogëlim i pagës”.

Tejkalimi i diskrecionit të vlerësimit të autoriteteve kompetente është shumë i shprehur në sistemin prokurorial. Mungesa e mbikëqyrjes së KPK-së ndaj autoriteteve kompetente dhe mos përfshirja e IAP-së ashtu siç përcaktohet me ligj në sistemin e llogaridhënies së prokurorëve ka krijuar mungesë të llogaridhënies tek vet KPK. Në jo pak raste, vet autoritetet kompetente kanë kryer shkelje disiplinore, por se janë amnistuar nga KPK. Disa nga vendimet e autoriteteve kompetente janë përfshirë në gabime të qarta profesionale, derisa IKD ka gjetur edhe qasje selektive të prokurorëve nga ana e autoriteteve kompetente.

Përmes arsyetimeve të shkurta dhe jo meritore, KGJK duke liruar nga përgjegjësia disiplinore gjyqtarë të caktuar, ka lejuar praktika të dëmshme brenda sistemit gjyqësor, si rastet kur dëshmitari del nga salla si i dënuar apo kur procesverbali konstatohet vetëm “copy-paste”.

IKD në raportin e kaluar mbi llogaridhënien kishte kritikuar qasjen e Avokatit të Popullit për mos veprim në rastet e hudhjeve të ankesave disiplinore nga ana e AK. Po ashtu, IKD avokonte vazhdimisht mbi të drejtën e Avokatit të Popullit për të parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme ndaj vendimeve të këshillit përkatës. Këtë qëndrim të IKD-së e ka vërtetuar GjS. IKD do të monitorojë punën e IAP nëse do të veprojë në përputhje me vendimin e GjS.

Më 5 nëntor 2021 ka hyrë në fuqi Ligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e LPDGjP. Ky ligj përmban vetëm një ndryshim të arsyeshëm. Por, Ministria e Drejtësisë me rastin e procedimit të këtij ligji në Qeverinë e Republikës së Kosovës ka injoruar nevojat reale për plotësim/ndryshimin e LPDGjP, duke injoruar komentet e dërguara nga IKD.

Duke vepruar në këtë mënyrë, MD ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren Nr.05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik. Krahas kësaj, MD nuk ka treguar përkushtim për të adresuar të metat praktike të zbatimit të LPDGjP, i cili synim final ka ngritjen e llogaridhënies në sistemin e drejtësisë.

Pamundësia e adresimit të mjaftueshëm të llogaridhënies në sistemin kosovar të drejtësisë edhe përmes LPDGjP fuqizon argumentin e trajtuar vazhdimisht nga IKD për nevojën e sistemit të drejtësisë për veting. Për më tepër, përderisa MD është duke e draftuar Koncept-Dokumentin për Zhvillimin e Procesit të Vetikut, gjetjet e këtij raporti duhet të shërbejnë si argument se procesi i vetikut duhet të zhvillohet përmes akterëve të jashtëm dhe jo brenda suazave aktuale të sistemit të drejtësisë.

## 2. Trajtimi i rasteve disiplinore nga sistemi gjyqësor dhe prokurorial

### 2.1.Sistemi gjyqësor


Gjatë vitit 2020 kryetarët e gjykatave kanë pranuar gjithsej 143 ankesa disiplinore ndaj gjyqtarëve. Nga statistikat e gjykatave, ajo që bie në sy është përqindja e lartë e rasteve të cilat janë refuzuar/hudhur nga ana e autoriteteve kompetente, e të cilat më pas nuk janë shqyrtuar fare nga KGJK. Përkatësisht, mbi 83% apo 119 ankesa disiplinore, janë mbyllur nga autoritetet kompetente/kryetarët e gjykatave. Kryetarët e gjykatave janë treguar shumë solidar me gjyqtarët në kuptim të mos inicimit të rasteve disiplinore sipas detyrës zyrtare. Në nëntë (9) gjykata, janë iniciuar vetëm shtatë (7) raste sipas detyrës zyrtare, tri (3) prej të cilave nga kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë. Në KGJK, autoritetet kompetente gjatë vitit 2020 kanë dërguar 21 raste.

Gjetje pothuajse të njëjta janë edhe për gjysmën e parë të vitit 2021, ku përqindja e rasteve të mbyllura nga autoritetet kompetente është mbi 87%. Përkatësisht, nga 54 ankesa disiplinore, kryetarët e gjykatave kanë hudhur 47 prej tyre, derisa sipas detyrës zyrtare janë iniciuar vetëm tri (3) raste. Gjatë kësaj periudhe kohore, autoritetet kompetente kanë dërguar në KGJK gjashtë (6) raste disiplinore.

Gjykata	Nr. i ankesave disiplinore		Rastet disiplinore të iniciuara sipas detyrës zyrtare		Të hudhura/refuzuara		Inicim në KGJK	
	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021
<b>GjS</b>	17	7	2	1	13	6	2	2
<b>GjA</b>	12	6	1	0	10	5	2	0
<b>GjTh Prishtinë</b>	61	19	1	0	50	19	11	0
<b>GjTh Pejë</b>	18	7	3	2	14	5	4	1
<b>GjTh Gjilan</b>	8	1	0	0	7	1	1	0
<b>GjTh Gjakovë</b>	5	3	0	0	5	3	0	0
<b>GjTh Prizren</b>	16	8	0	0	15	5	0	3
<b>GjTh Ferizaj</b>	3	1	0	0	2	1	1	0
<b>GjTh Mitrovicë</b>	3	2	0	0	3	2	0	0
<b>Total</b>	143	54	7	3	119	47	21	6

**Tabela 1: Numri i ankesave disiplinore të pranuar dhe trajtuara nga autoritetet kompetente të sistemit gjyqësor (1 janar 2020 – 30 qershor 2021).**

Edhe në rastet të cilat gjatë vitit 2020 kanë shkuar në KGJK nga autoritetet kompetente, në shumicën absolute të tyre, KGJK ka liruar gjyqtarët nga përgjegjësia disiplinore.



**Grafika 1. Vendimet e KGJK-së gjatë vitit 2020 lidhur me procedurat disiplinore të iniciuara ndaj gjyqtarëve.**


Në KGJK thonë se për nxjerrjen e vendimeve disiplinore janë zhvilluar të gjitha procedurat, duke theksuar se KGJK është organ kolegjal dhe se të gjitha vendimet merren me shumicë votash, andaj edhe vendimet disiplinore pas gjitha këtyre shqyrtimeve janë votuar nga shumica ose unanimisht nga anëtarët e KGJK-së. “Shumica e vendimeve disiplinore të KGJK e kanë kaluar edhe fazën e ankesës” thuhet në përgjigjen e KGJK-së për këtë raport<sup>1</sup>.

Sa i përket llojeve të masave disiplinore, KGJK në përgjigje për këtë raport ka thënë se ky institucion ka shqiptuar sanksionet disiplinore vetëm në përputhje me parimin e proporcionalitetit në raport me shkeljen e vërtetuar, derisa hudojnë ankesave disiplinore nga autoritetet kompetente, KGJK ka theksuar se nuk ka të drejtë ti komentojë.

Gjetje e njëjtë është edhe sa i përket periudhës kohore 1 janar – 30 qershor 2021, ku dominon numri i vendimeve për lirimin e gjyqtarëve nga përgjegjësia disiplinore:

<sup>1</sup> Komentet e KGJK-së për draftin e raportit mbi llogaridhënien e gjyqtarëve dhe prokurorëve. 23 shtator 2021.





**Grafika 2:– Vendimet e KGJK-së në gjysmën e parë të vitit 2021 lidhur me procedurat disiplinore të iniciuara ndaj gjyqtarëve**

## 2.2.Sistemi prokurorial

Lidhur me sistemin prokurorial, sa i përket vitit 2020, IKD ka gjetur se disa prokurori nuk kanë gjeneruar fare statistika sa i përket rasteve disiplinore. Sidoqoftë, si në rastin e sistemit gjyqësor, IKD gjen se edhe tek sistemi prokurorial, numri i ankesave disiplinore të mbyllura nga autoritetet kompetente është shumë i lartë. Nga të dhënat që IKD ka pranuar nga të gjitha prokuroritë, në vitin 2020, përqindja e rasteve të mbyllura nga kryeprokurorët është 83.3%. Përkatesisht, nga 42 ankesat e pranuar, kryeprokurorët kanë mbyllur 35 prej tyre. Në vitin 2021, kjo përqindje mbërrin në 86.4%, ku kryeprokurorët kanë mbyllur 32 nga 37 ankesat disiplinore.


Prokuroria	Nr. i ankesave disiplinore		Rastet disiplinore të iniciuara sipas detyrës zyrtare		Të hudhura/refuzuara		Inicim në KPK	
	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021
ZKSh <sup>2</sup>	/	/	/	/	/	/	/	/
PA	0	0	0	0	0	0	0	0
PSRK	4	2	0	0	4	2	0	0
PTh Prishtinë	15	11	0	1	10	10	4	1
PTh Pejë	12	7	1	0	11	6	1	1
PTh Gjilan	2	2	0	1	2	2	0	1
PTh Gjakovë <sup>3</sup>	/	4	/	0	/	3	/	1
PTh Prizren	7	3	0	1	7	2	0	1
PTh Ferizaj	2	5	0	0	1	4	0	0
PTh Mitrovicë	0	3	0	0	0	3	0	0
<b>Total</b>	<b>42</b>	<b>37</b>	<b>1</b>	<b>3</b>	<b>35</b>	<b>32</b>	<b>5</b>	<b>5</b>

**Tabela 2: Numri i ankesave disiplinore të pranuar dhe trajtuara nga autoritetet kompetente të sistemit prokurorial (1 janar 2020 – 30 qershor 2021).**

Edhe në KPK, gjatë vitit 2020 përqindja absolute e vendimmarrjes ka qenë lirimi i prokurorëve nga përgjegjësia disiplinore. Sa i përket masave të tjera, masa më e rëndë që KPK ka shqiptuar gjatë vitit 2020 dhe gjysmës së parë të vitit 2021 është ulja e pagës.


<sup>2</sup> Shënim: ZKSh nuk ka kthyer përgjigje, përkundër kërkesave të vazhdueshme.

<sup>3</sup> Shënim: Prokuroria Themelore në Gjakovë përmes përgjigjes elektronike të datës 5 korrik 2021 ka njoftuar se nuk kanë të dhëna sa i përket rasteve disiplinore për vitin 2020.



**Grafika 3: Vendimet e KPK-së gjatë vitit 2020 lidhur me procedurat disiplinore të iniciuara ndaj prokurorëve.**

Në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2021, KPK ka marrë një (1) vendim për lirim nga përgjegjësia disiplinore dhe një (1) vërejtje jopublike me shkrim.



**Grafika 4 – Vendimet e KPK-së në gjysmën e parë të vitit 2021 lidhur me procedurat disiplinore të iniciuara ndaj prokurorëve.**

### 2.3. Institucioni i Avokatit të Popullit

Edhe sa i përket Avokatit të Popullit, dominon numri i ankesave disiplinore të cilat janë hudhur nga ky institucion. Nga 16 ankesat e pranuar nga ky institucion gjatë vitit 2020 dhe gjysmës së parë të vitit 2021, nëntë (9) prej tyre janë hudhur/refuzuar, derisa gjatë vitit 2020, ky institucion ka dërguar në KPK gjithsej gjashtë (6) raste ndërsa në KGJK vetëm një (1) rast, derisa në vitin 2021 nuk ka dërguar asnjë rast, qoftë në KGJK apo në KPK.

Institucioni i Avokatit të Popullit			
Viti	Nr. i ankesave disiplinore	Të hudhura/refuzuara	Inicim në KGJK
2020	15	8	1
2021	1	1	0

Tabela 3: Numri i ankesave disiplinore të pranuar dhe trajtuara nga IAP (1 janar 2020 – 30 qershor 2021).

### 3. Inicimi i procedurave disiplinore nga IKD

IKD përgjatë vitit 2020 dhe 2021, ka iniciuar gjithsej 24 ankesa disiplinore, të cilat ankesa disiplinore janë derivat i gjetjeve të IKD-së gjatë procesit të monitorimit sistematik që IKD i bënë sistemit të drejtësisë. Shkeljet e supozuara disiplinore që janë objekt i këtyre ankesave disiplinore kanë të bëjnë me shkelje të kodeve të etikës, shkelje të drejtave të pandehurve, cenim të sigurisë juridike, mos përfaqësim i duhur i aktakuzave, dështim të mbajtjes së rendit në gjykatore etj. Të gjitha këto ankesa janë hartuar ekskluzivisht duke u bazuar në LPDGjP dhe rregulloret përkatëse.

Sa i përket prokurorëve, IKD gjatë vitit 2020 dhe 2021 ka iniciuar gjithsej 16 ankesa disiplinore, derisa ndaj gjyqtarëve janë iniciuar gjithsej tetë (8) ankesa disiplinore. Detajet për ankesat disiplinore dhe vendimet e marra përkitazi me këto ankesa, janë pjesë e shtojcës 1 të këtij raporti.

### 4. Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rasteve disiplinore nga sistemi prokurorial<sup>4</sup>

Mungesa e kontrollit të KPK-së ndaj vendimeve të autoriteteve kompetente dhe mos përfshirja adekuate e Institucionit të Avokatit të Popullit në llogaridhënien e gjyqtarëve dhe prokurorëve u ka mundësuar autoriteteve kompetente tejkalimin e kompetencave të tyre sipas LPDGjP si dhe ka krijuar mungesë të llogaridhënies të vet autoriteteve kompetente. Dispozitat e LPDGjP dhe

<sup>4</sup> Shënim: Përkundër faktit se KGJK dhe KPK publikojnë edhe emrat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, IKD me qëllim të ruajtjes së integritetit dhe profesionalizmit, nuk ka paraqitur emrat e gjyqtarëve dhe prokurorëve që kanë qenë subjekte të ankesave disiplinore. Përkundër faktit se këta emra janë të njohur për IKD, ky raport trajton mënyrën e funksionimit të llogaridhënies në sistemin e drejtësisë dhe jo rastet e ndara disiplinore.

standardet ndërkombëtare përcaktojnë kompetencat dhe rolin e autoriteteve kompetente<sup>5</sup>. Këta të fundit, shërbejnë vetëm për filtrimin e ankesave disiplinore dhe për të vlerësuar nëse një rast përbën “rast disiplinor”, por jo edhe për të vlerësuar përgjegjësinë disiplinore të një subjekti, gjyqtarit apo prokurorit në këtë rast.

Në praktikë, kjo nuk ka ndodhur kështu. Kjo pasi kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët nuk i kanë dhënë fare mundësi KPK-së që të vlerësojë përgjegjësinë disiplinore të një prokurori, pasi në kundërshtim me nivelin e kompetencave të tyre, të njëjtit kanë hedhur ankesat disiplinore. Përballë katër (4) kritereve ligjore që ka mundësi të vlerësojë autoriteti kompetent (dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore, ose është parashkruar), autoritetet kompetente kanë hudhur këto ankesa disiplinore duke tejkaluar nivelin e diskrecionit të tyre, përkatësisht duke kaluar në diskrecionin e vlerësimit të i takon KPK-së.<sup>6</sup> Në gjithsej 15 raste ku autoritetet kompetente kanë nxjerrë vendim mbi ankesat disiplinore të parashtruara nga IKD, në 13 prej tyre autoritetet kompetente kanë refuzuar ankesat disiplinore.

Në pesë (5) raste disiplinore, vet autoritetet kompetente kanë kryer shkelje disiplinore siç e parasheh neni 9.7. i LPDGJP, për shkak të mos nxjerrjes së vendimit brenda afatit ligjor<sup>7</sup>, derisa në një (1) rast, AK nuk ka vendosur fare<sup>8</sup>. Për këto shkelje disiplinore të autoriteteve kompetente, KPK nuk ka marrë veprime duke amnistuar shkeljet e tyre. Pas përfundimit të afatit ligjor të autoriteteve kompetente që të nxjerrin vendim përkritazi me ankesat disiplinore, IKD ka parashtruar ankesa tek Avokati i Popullit për mos përgjigje të autoriteteve kompetente. Mbi bazën e ankesave të IKD-së, Avokati i Popullit më 20 gusht 2020 ka parashtruar në KPK kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore. Këtë kërkesë, KPK e ka hedhur si jo substanciale. Për njërin rast, KPK e ka arsyetuar një kryeprokuror me një gabim teknik lidhur me postën elektronike. Në rastin tjetër, KPK e ka pranuar arsyetimin e kryeprokurorit se asnjëherë nuk e ka pranuar ankesën disiplinore në fjalë, përkundër faktit se IKD e ka dërguar këtë ankesë në emailat që zakonisht i dërgon ankesat disiplinore. Në tri (3) raste të tjera, KPK e ka arsyetuar kryeprokurorin me pandeminë COVID-19, përkundër faktit se ankesat disiplinore ishin parashtruar para se në Kosovë të shënoheshin rastet e para me COVID-19<sup>9</sup>.

Vendimet e autoriteteve kompetente janë përfshirë edhe në gabime të qarta profesionale, të cilat gabime kanë amnistuar prokurorët. I tillë është rasti i prokurores F.F., rasti i së cilës në asnjë

---

<sup>5</sup> “COMPILATION OF VENICE COMMISSION OPINIONS, REPORTS AND STUDIES ON CONSTITUTIONAL JUSTICE (UPDATED)”. EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION). CDL-PI(2017)008. Strasbourg , 18 Dhjetor 2017. F. 40.

<sup>6</sup> Vendimet e AK mbi ankesat disiplinore ndaj prokurorëve B.M, L.V. dhe S.M., D.H., Rr.P., J.P., H.K. dhe F.B..

<sup>7</sup> Vendimet e autoriteteve kompetente mbi ankesat disiplinore ndaj prokurorëve B.M., H.K., Rr.P, FS. dhe J.P..

<sup>8</sup> Ankesa disiplinore e IKD-së, e parashtruar ndaj dy (2) prokurorëve. 10 shkurt 2020.

<sup>9</sup> Këshilli Prokurorial i Kosovës. Vendimi Nr.404/2020. 31 gusht 2020.; Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. Aktvendimi Nr.A.A.nr.9/2020. 26 tetor 2020.

rrethanë nuk konsiderohet të jetë parashkruar, por si të tillë e ka konsideruar kryeprokurori i PSRK-së<sup>10</sup>.

Në një rast tjetër, autoriteti kompetent e ka kundërshtuar gjendjen faktike, përkundër se gjendja faktike ishte vërtetuar përmes aktgjykimit të Gjykatës së Apelit<sup>11</sup>.

Emisioni “Betimi për Drejtësi” në një rast kishte gjetur se njoftimi i PTh Prishtinë për arrestimin e një zyrtari të saj, ishte bërë para se zyrtari të arrestohej. “...i dyshuari kundër aktvendimit mbi ndalimin e tij, ka pasur të drejtë të paraqes ankesë...”, thuhej në arsyetimin e vendimit për refuzimin e ankesës disiplinore të IKD-së<sup>12</sup>.

Gjatë monitorimit të llogaridhënies, IKD ka gjetur se autoriteti kompetent i PTh në Prishtinë, ka pasur qasje selektive në raport me prokurorët. Kjo pasi përderisa për prokurorin B.M.<sup>13</sup> e kishte hudhur ankesën disiplinore me pretendimin se vendimmarrja e tij është e pavarur, në kundërshtim me këtë kishte ushtruar ankesë disiplinore sipas detyrës zyrtare ndaj prokurorit E.R.<sup>14</sup>.

Në një rast tjetër, ku prokurori nuk i kishte kthyer përgjigje gjykatës dhe aktakuza për një dëm mbi 160,000.00 euro ishte hudhur, autoriteti kompetent e kishte arsyetuar prokurorin me faktin se kishte qenë i infektuar me COVID-19, duke mos arsyetuar se pse gjatë kohës sa prokurori ka qenë i infektuar, nuk është caktuar prokurorë tjetër<sup>15</sup>.

Nga monitorimi nga afër i sistemit të llogaridhënies në sistemin e drejtësisë, IKD gjen se mungesa e vullnetit për të mbajtur përgjegjës prokurorët dhe gjyqtarët vazhdon të jetë sfida kryesore. Qasja amnistuese, neglizhuese dhe selektive e këtij sistemi ka stagnuar avancimin e sistemit të drejtësisë, veçanërisht në kuptim të ngritjes së besimit të publikut në këtë sistem.

## 5. Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rasteve disiplinore nga sistemi gjyqësor

Për dallim nga sistemi prokurorial, problematika e tejkalimit të kompetencave nga autoritetet kompetente është më pak e shprehur tek sistemi gjyqësor. Në këtë të fundit, problematike paraqitet vet KGJK, vendimet e së cilës në shumicën e rasteve janë lirimi i gjyqtarëve nga përgjegjësia disiplinore.

---

<sup>10</sup> Shala G. “Llogaridhënia e gjykatësve dhe prokurorëve”. IKD. 2020. F.69-71

<sup>11</sup> Po aty. F.71.

<sup>12</sup> Vendimi i AK lidhur me ankesën ndaj prokurores J.P..

<sup>13</sup> Shala G. “Llogaridhënia e gjykatësve dhe prokurorëve”. IKD. 2020. F.66.

<sup>14</sup> “Pezullohet prokurori që liroi policin i cili rrahu të riun në stacionin policor”. Koha.net. 1 shkurt 2021. (shih linkun <https://www.koha.net/arberi/256698/pezullohet-prokurori-i-rastit-te-policit-qe-rrahu-te-riun-ne-stacionin-policor/> ). (Qasur për herë të fundit më 20 shtator 2021).; “Gjykata Supreme: Prokurori i pezulluar që liroi policin që keqtrajtoi të riun, E.R., nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore”. Betimi për Drejtësi. 17 maj 2021. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-supreme-prokurori-i-pezulluar-qe-liroi-policin-qe-keqtrajtoi-te-riun-eset-rama-nuk-eshte-pergjegjes-per-shkelje-disiplinore/> ).(Qasur për herë të fundit më 20 shtator 2021).

<sup>15</sup> Vendimi i AK lidhur me ankesën e IKD dhe BpD ndaj prokurorit F.B..

Nga tetë (8) vendimet e autoriteteve kompetente përkitazi me ankesat disiplinore ndaj gjyqtarëve, katër (4) prej tyre janë aprovuar, derisa katër (4) të tjera janë refuzuar.

Në njërën prej ankesave të refuzuara, autoriteti kompetent ka kontestuar gjendjen faktike të paraqitur nga IKD, duke u thirrur vetëm në procesverbal dhe duke e injoruar aktgjykimin e GjA i cili konstaton gjendjen faktike relevante<sup>16</sup>. Në rastin tjetër, vendimi refuzues nga autoriteti kompetent, Kryetari i Gjykatës Supreme, është marrë duke mos u bazuar në katër (4) rrethanat ligjore se kur Kryetari i Gjykatës mund të refuzojë një ankesë disiplinore<sup>17</sup>.

Sa i përket ankesave disiplinore të cilat janë aprovuar nga autoritetet kompetente përmes parashtrimit të kërkesave në KGJK për fillimin e hetimeve disiplinore, në të gjitha këto raste KGJK ka liruar gjyqtarët nga përgjegjësia disiplinore.

Në rastin e gjyqtarit V.I., N.K.-J. dhe N.K.-M. ankesa e IKD-së kishte të bënte me dështimin e trupit gjykues që të mbante rendin në gjykatore pas sharjeve që kishin ardhur nga i akuzuari, i cili ishte revoltuar pas publikimit të një lajmi nga BpD, ku i akuzuari shihej duke shikuar ndeshje të boksit gjatë gjykimin<sup>18</sup>. Përballë fyerjeve dhe ofendimeve që trupi gjykues i kryesuar nga gjyqtari V.I. kishte lejuar ndaj monitorueses së IKD-së, vendimi i KGJK-së e orienton arsyetimin në pamundësinë e trupit gjykues për të ndaluar ndeshjen e boksit dhe jo dështimin e të njëjtit për të vënë rend në gjykatore. “Nga dëshmitë e dëshmitarëve, u vërtetua se fyerja është bërë gjatë kohës kur trupi gjykues ka qenë jashtë sallës” thuhet në vendimin e KGJK-së<sup>19</sup>, i cili vendim nuk tregon fare se kush janë dëshmitarët që kanë deklaruar këtë.

Rastin kur kolegji i Gjykatës së Apelit ka obliguar vazhdimin e procesit për një aktakuzë të pasafatshme<sup>20</sup>, KGJK e ka cilësuar si vendosje të lirë të gjyqtarëve. Duke vepruar në këtë mënyrë, KGJK ka amnistuar kolegjin në fjalë. Arsyetimi i këtij vendimi, përmban një (1) paragraf<sup>21</sup>.

Ndërsa në rastin ku gjyqtari e lejon dëshmitarin të dal nga gjykata si i dënuar,<sup>22</sup>KGJK e ka liruar nga përgjegjësia disiplinore me arsyetimin se pala e pakënaqur ka pasur të drejtë ankese.<sup>23</sup> Me një

---

<sup>16</sup> Vendimi i AK lidhur me ankesën e IKD dhe BpD ndaj prokurorëve L.V dhe S.M..

<sup>17</sup> Vendimi i AK lidhur me ankesën e IKD dhe BpD ndaj gjyqtarit S.Sh..

<sup>18</sup> Shala G. “Llogaridhënia e gjykatësve dhe prokurorëve”. IKD. 2020. F.50-51.

<sup>19</sup> KGJK. Vendimi Nr.247/2020. 26.10.2020. (Shih linkun [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/12879\\_Vendim\\_KGJK\\_Nr\\_247\\_2020\\_Vendim\\_per\\_rastin\\_disiplinor\\_Nr\\_AD\\_KGJK\\_17\\_2019\\_AD\\_GJTHPR\\_14\\_19.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/12879_Vendim_KGJK_Nr_247_2020_Vendim_per_rastin_disiplinor_Nr_AD_KGJK_17_2019_AD_GJTHPR_14_19.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 21 shtator 2021).

<sup>20</sup> Shala G. “Llogaridhënia e gjykatësve dhe prokurorëve”. IKD. 2020. F.31-33.

<sup>21</sup> KGJK. Vendimi Nr. 291/2020. 7 dhjetor 2020. (shih linkun [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/49880\\_KGJK\\_Vendimi\\_Nr\\_291\\_2020.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/49880_KGJK_Vendimi_Nr_291_2020.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 21 shtator 2021).

<sup>22</sup> Shala G. “Llogaridhënia e gjykatësve dhe prokurorëve”. IKD. 2020. F.41-42.

<sup>23</sup> Vendimi i KGJK. Nr. 260/2020. 18 nëntor 2020. (shih linkun [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/24899\\_Vendimi\\_KGJK\\_se\\_Nr\\_260\\_2020.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/24899_Vendimi_KGJK_se_Nr_260_2020.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 21 shtator 2021).

arsyetim pothuajse të njëjtë, KGJK e ka liruar nga përgjegjësia disiplinore<sup>24</sup> edhe gjyqtarin që në procesverbal lejoi konstatimet “copy-paste”<sup>25</sup>.

Përballë këtyre gjetjeve, në komentet e KGJK-së thuhet se nuk janë ofruar të dhëna mbi amnistimin e gjyqtarëve, duke konsideruar se në vendimmarrjen e KGJK-së lidhur me rastet disiplinore, kjo nuk ka ndodhur. Po ashtu, në këto komente thuhet se gjatë zbatimit në praktikë, KGJK ka evidentuar shumë zbrazëtira në LPDGjP, të cilat do të adresohen në MD<sup>26</sup>.

## 6. Avokati i popullit përballë llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve

Që nga miratimi i LPDGjP, Institucioni i Avokatit të Popullit ka mbajtur qëndrimin se ky institucion ka në kompetencë të shqyrtojë vetëm rastet kur autoritetet kompetente nuk nxjerrin fare vendim brenda afatit të përcaktuar me ligj, por jo edhe në rastet kur ky institucion gjen arsye se ankesa disiplinore nuk do duhej të hidhej nga autoriteti kompetent. Këtë qasje të Institucionit të Avokatit të Popullit IKD e kishte kundërshtuar edhe në takim me përfaqësues të IAP-së ashtu edhe në raportin e fundit të IKD-së mbi llogaridhënien e gjyqtarëve dhe prokurorëve<sup>27</sup>. Por, pretendime të Institucionit të Avokatit të Popullit se personat fizik dhe juridik mund ti drejtohen Këshillit Prokurorial për pretendimet disiplinore ndaj prokurorëve apo autoritetit kompetent janë rrëzuar nga ana e GjS.

IKD kishte parashtruar ankesë disiplinore tek autoriteti kompetent, kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë. Pasi që i njëjti nuk kishte nxjerrë vendim përkitazi me këtë ankesë brenda afatit ligjor, IKD i është drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit. Ky i fundit, kishte iniciuar rastin në KPK, por se KPK e kishte refuzuar këtë ankesë<sup>28</sup>. Pas këtij vendimi të KPK-së, IKD i ka parashtruar IAP kërkesë për ushtrimin e mjetit juridik në Gjykatën Supreme<sup>29</sup>. Por, IAP e ka refuzuar këtë kërkesë dhe ka udhëzuar IKD-në që në përputhje me nenin 15.1. të LPDGjP të parashtrrojë ankesë në Gjykatën Supreme<sup>30</sup>. Pas kësaj, IKD dhe BpD kanë parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës<sup>31</sup>. Me këtë rast, pretendimet e IKD janë vërtetuar nga GjS.

Përkundër kësaj, fatkeqësisht, IAP përsëri nuk ka reflektuar përballë rolit të tij që ka në sistemin e llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në komentet e IAP-së për këtë raport, duke cituar parciaisht dispozitat ligjore dhe aktvendimin e GjS të trajtuar si më lartë, IAP ka vazhduar të

---

<sup>24</sup> Vendimi i KGJK. Nr.292.2020. 7 dhjetor 2020. (Shih likun [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/18121\\_KGJK\\_Vendimi\\_Nr\\_292\\_2020.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/18121_KGJK_Vendimi_Nr_292_2020.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 21 shtator 2021).

<sup>25</sup> Shala G. “Llogaridhënia e gjykatësve dhe prokurorëve”. IKD. 2020. F.61-62.

<sup>26</sup> Komentet e KGJK-së për draftin e raportit mbi llogaridhënien e gjyqtarëve dhe prokurorëve. 23 shtator 2021.

<sup>27</sup> Po aty. F. 84-86.

<sup>28</sup> Vendimi i KPK. Nr. 404/2020. 31 gusht 2020.

<sup>29</sup> Kërkesë për Ushtrimin e Ankesës në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës ndaj Vendimit Të KPK-së Nr.404/2020. IKD dhe BpD. 21 shtator 2020.

<sup>30</sup> Përgjigja e IAP. 22 shtator 2020.

<sup>31</sup> Ankesa e IKD dhe BpD në Gjykatën Supreme. 23 shtator 2020.



mbajë qëndrim se ky institucion nuk ka mandat që të veprojë në rastet kur autoritetet kompetente hudhin ankesat disiplinore, por vetëm në rastet kur autoritetet kompetente nuk nxjerrin fare vendim mbi një ankesë disiplinore.

“Nuk mund të thuhet se këto pretendime e Avokatit të Popullit janë rrëzuar nga Gjykata Supreme. Qëndrim i jonë është në përputhje me Neni 12.3 të LPDGJP dhe është konfirmuar me Aktvendimin e Gjykatës Supreme A.A.nr.9/2020 të datës 15 tetor 2020 (shih paragrafin 1. faqe 6 të Aktvendimit)” thuhet në komentet e IAP-së për këtë raport. Tutje, duke pranuar dallimet në mes të IKD dhe IAP, kjo e fundit në komentet për këtë raport nënvizon se “Qëndrimi i Avokatit të Popullit lidhur me kërkesën për hetim disiplinor nga KGJK dhe KPK është në pajtim me kompetencat e parapara me Ligjin nr. 06/L-057. Sipas nenit 12, paragrafi 3, në rast të pranimi të ankesës Avokati i Popullit mund të kërkojë nga Këshilli që të filloi hetimet disiplinore ndaj një Kryetari të Gjykatës ose Kryeprokurorit nëse kanë arsye të besojnë se ai ka kryer shkelje disiplinore sipas nenit 9, paragrafit 7 i këtij Ligji “Nëse Kryetari i Gjykatës ose Kryeprokurori nuk shqyrton dhe nuk vendos lidhur me ankesën ose nuk njofton personin që ka paraqitur ankesë për arsyet e hedhjes poshtë të ankesës, siç kërkohet në paragrafin 6, konsiderohet se kanë kryer shkelje disiplinore”. Avokati i Popullit, gjithashtu mund të kërkojë nga Këshilli përkatës, fillimin e hetimeve disiplinore ndaj një gjyqtari ose prokurori nëse konsiderohet se Autoriteti Kompetent ka marrë vendim për hedhjen poshtë të ankesës ndaj atij gjyqtari ose prokurori në kundërshtim me nenin 9, paragrafin 5, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve: “Çdo ankesë zyrtare duhet të regjistrohet dhe të arkivohet nga Autoriteti Kompetent, i cili menjëherë i dërgon një njoftim me shkrim Këshillit përkatës lidhur me pranimin e një ankese të tillë.....” thuhet në komentet e IAP-së për këtë raport<sup>32</sup>.

Në këtë rast, IAP shkarazi e citon dispozitën e cila i jep të drejtë këtij institucioni për të vepruar edhe në rastet e hudhjeve të ankesave disiplinore nga autoritetet kompetente, kur nënvizon se “Avokati i Popullit, gjithashtu mund të kërkojë nga Këshilli përkatës, fillimin e hetimeve disiplinore ndaj një gjyqtari ose prokurori nëse konsiderohet se Autoriteti Kompetent ka marrë vendim për hedhjen poshtë të ankesës ndaj atij gjyqtari ose prokurori”. Por, dispozitën referuese, nenin 9.5. të LPDGJP, IAP e citon vetëm parcialisht. Pjesën “Në rast se Avokati i Popullit pranon ndonjë ankesë, ai duhet t’ia përcjell atë Autoritetit Kompetent të përcaktuar në nenin 9, paragrafi 1, brenda pesë (5) ditëve të punës”, IAP nuk e përmend fare në komentet e saja<sup>33</sup>.

Në vendimin e Gjykatës Supreme përkitazi me këtë ankesë, ndër të tjera, nënvizohet se “Avokati i Popullit, mund të kërkojë fillimin e hetimeve disiplinore tek Këshilli Prokurorial, ndaj kryeprokurorit dhe ndaj ndonjë prokurori në situatën kur kryeprokurori ka konsumuar shkeljen disiplinore nga neni 9, paragraf 7 i Ligjit, e që ka të bëjë me mos shqyrtimin e ankesës apo mos njoftimin e ankuesit për arsyet e hedhjes së ankesës. Po ashtu Avokati i Popullit, mund të kërkojë fillimin e hetimeve disiplinore tek Këshilli Prokurorial ndaj një prokurori kur Autoriteti

---

<sup>32</sup> Komentet e IAP për draftin e raportit të llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve. 28 shtator 2021.

<sup>33</sup> Po aty.

Kompetente (Kryeprokurori) ka marrë vendim për hedhjen poshtë të ankesës në kundërshtim me nenin 9, paragrafi 5 i Ligjit, e që ka të bëjë me situatën kur ankuesi e ka dorëzuar ankesën tek Avokati i Popullit, ndaj një prokurori, ndërsa Avokati i Popullit sipas detyrimeve ligjore e ka përcjellë ankesën tek autoriteti kompetente (Kryeprokurori). Kur ankesën e përcjellë Avokati i Popullit tek autoriteti kompetent (Kryeprokurori), atëherë ky autoritet ka detyrim ligjor që ta njoftoj me një kopje të vendimit Avokatin e Popullit dhe në këtë rast ky i fundit është subjekt i autorizuar ligjërisht që të kërkoj hetimin disiplinor tek Këshilli Prokurorial.

“Është me rëndësi të theksohet se personat fizik dhe juridik mund të ushtrojnë ankesë ndaj një prokurori tek Avokati i Popullit (neni 9, paragrafi 3 i Ligjit), mirëpo Avokati i Popullit duhet t’ a përcjellë ankesën tek autoriteti kompetent (Kryeprokurori) brenda afatit prej 5 ditë pune. Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i ka dhënë mundësi secilit person fizik dhe juridik që të parashtror ankesë ndaj një prokurori tek autoriteti kompetent apo tek Avokati i Popullit, i cili duhet që ankesën ta përcjell tek Autoriteti Kompetent, mirëpo nuk i ka dhen mundësi ligjore personave fizik dhe juridik që të parashtrorjnë kërkesë për fillimin e hetimit disiplinor tek Këshilli Prokurorial, ndaj autoritetit kompetente (Kryeprokurorit) kur autoriteti kompetent ka konsumuar shkeljen disiplinore apo ndaj një prokurori në situata të paracaktuara ligjërisht, sepse për këtë veprim është i autorizuar vetëm Avokati i Popullit...” thuhet në aktgjykimin e GjS<sup>34</sup>.

Sa i përket të drejtës së Avokatit të Popullit për ushtrimin e së drejtës së ankesës në GjS, vendimi në fjalë nënvizon se “...interpretimi me referencë në nenin 12, paragraf 3 të Ligjit, i jep mundësi Avokatit të Popullit si subjekt i autorizuar të ushtroj ankesë edhe për situatën e mos veprimit të këshillit përkatës sipas kërkesës për fillimin e hetimit disiplinor, por edhe për situatën e mos njoftimit të subjektit që ka parashtruar kërkesë për fillimin e hetimit disiplinor për arsyet e hedhjes së kërkesës si dhe për respektimin e afatit të vendosjes. Në këtë mënyrë përmes së drejtës së ankesës nga Avokati i Popullit krijohet mundësi e kundërshtimit të veprimeve apo mosveprimeve të subjekteve që kanë përgjegjësi ligjore lidhur me zhvillimin dhe vendosjen e procedurave disiplinore. Përmbajtja e dispozitës së nenit 12, paragraf 3 të Ligjit, që ka të bëjë me parashtrimin e kërkesës për fillimin e procedurës disiplinore për raste të caktuara nga ana e Avokatit të Popullit, zbatohet në mënyrë analoge për ato raste edhe për ushtrimin e së drejtës së ankesës nga Avokati i Popullit në Gjykatën Supreme të Kosovës” thuhet ndër të tjera në aktgjykimin e GjS mbi ankesën e parashtruar nga IKD dhe BpD<sup>35</sup>.

Në këtë mënyrë, aktgjykimi i GjS ka konfirmuar pretendimet e vazhdueshme të IKD-së lidhur me rolin e Avokatit të Popullit në procesin e disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në këtë mënyrë, aktgjykimi i GjS e precizon qartë se në sistemin e disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Avokati i Popullit nuk paraqitet vetëm në rastin kur autoritetet kompetente nuk vendosin brenda afateve të përcaktuara me ligj, por edhe në rastet kur Avokati i Popullit vlerëson se ankesa disiplinore nuk do duhej të hidhej nga autoriteti kompetent. Po ashtu, ky aktgjykim i GjS

<sup>34</sup> Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. Aktvendim. A.A.nr.9/2020.

<sup>35</sup> Po aty.

konfirmon edhe pretendimet e IKD lidhur me të drejtën e Avokatit të Popullit për të parashtruar ankesë në GjS ndaj vendimit të këshillit përkatës.

Keqkuptimi i Avokatit të Popullit për rolin që ka në disiplinimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ka qenë shumë problematik sa i përket llogaridhënies së këtyre akterëve. Kanë qenë disa ankesa disiplinore të IKD dhe BpD të cilat janë hedhur me këtë pretendim. Po ashtu, edhe në rastin që e trajtuam paraprakisht, për shkak të këtij keqkuptimi, Avokati i Popullit nuk ka ushtruar as ankesë në GjS, duke udhëzuar që këtë ta bëjë IKD. Duke mos pasur zgjidhje tjetër, IKD ka parashtruar këtë ankesë, e cila ashtu siç e përcakton ligji dhe siç e ka arsyetuar GjS, është e palejuar.

Kjo qasje e Institucionit të Avokatit të Popullit i ka kontribuar neglizhencës së sistemit të drejtësisë në drejtim të ngritjes së llogaridhënies. Mungesa e përfshirjes së IAP në këtë fushë ashtu siç përcaktohet me ligj, ka bërë që ndaj vendimeve të autoriteteve kompetente mos të ketë asnjë mjet juridik, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

## **7. Heshtja e MD-së përballë nevojave të avancimit të ligjit**

MD kishte iniciuar plotësim/ndryshimin e LPDGjP. Më 26 tetor 2020, në Platformën e Konsultimeve Publike ishte publikuar projektligji në fjalë. Sipas këtij projektligji, në LPDGjP do të ndryshohej vetëm një nen. Sipas këtij projektligji *“Neni 12, paragrafi 9 riformulohet si vijon: 9. Gjatë procedurës hetimore, Këshilli ex officio ose me kërkesë të Autoritetit Kompetent i cili ka kërkuar fillimin e hetimeve, mund të suspendojë gjyqtarin ose prokurorin i cili është nën hetime nëse një gjë e tillë është e nevojshme duke marrë parasysh seriozitetin e shkeljes së supozuar disiplinore dhe të sigurohet integriteti dhe efektiviteti i hetimeve”*<sup>36</sup>.

Duke mirëpritur ndryshimin e propozuar nga MD, IKD kishte paraqitur 12 faqe komente mbi nevojat e LPDGjP për tu ndryshuar/plotësuar. Këto komente kishin ardhur pasi IKD nga monitorimi i këtij projektligji, i cili monitorim është bërë nga afër përmes parashtrimit të ankesave disiplinore, kishte evidentuar sfidat praktike të zbatimit të LPDGjP. Këto komente kishin të bënin me disa çështje të LPDGjP, si shkeljet disiplinore, përkufizimet, ankesat ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, procedura hetimore, procedurat disiplinore dhe ankesa ndaj vendimeve disiplinore. Për më tepër, në këto komente reflektoheshin edhe pikëpamje praktike në kuptim të vendimit të GjS, të cituar në kapitullin paraprak.

Në kohën kur dokumenti për konsultim publik lidhur me LPDGjP është publikuar, Ministria e Drejtësisë drejtohej nga z. Selim Selimi, i cili më 22 mars 2021 u pasua nga Ministrja e Drejtësisë, znj. Albulena Haxhiu. Këto nevoja në raport me avancimin e LPDGjP janë injoruar nga MD, si në mandatin e z. Selimi ashtu edhe në mandatin e znj. Haxhiu. Kjo e fundit, ka dërguar për miratim

---

<sup>36</sup> Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/l - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Platforma e Konsultimeve Publike. Zyra për Qeverisje të Mirë. Zyra e Kryeministrit. 26 tetor 2020. (Shih linkun <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40969>). (Qasur për herë të fundit më 21 shtator 2021).

në Qeveri projektligjin me vetëm një (1) ndryshim, duke injoruar të gjitha shqetësimet e ngritura nga IKD. Projektligji me vetëm një (1) ndryshim është miratuar nga Qeveria më 21 prill 2021 dhe i njëjti është miratuar nga Kuvendi dhe ka hyrë në fuqi më 5 nëntor 2021. Në këtë mënyrë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka përmbushur formalisht agjendën legislative sa i përket miratimit të Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e LPDGjP, por nuk ka adresuar nevojat reale të këtij ligji.

Shpërfillja e këtyre komenteve paraqet shkelje të Rregullores (QRK) Nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik. Neni 15, paragrafi 1 dhe 2. i kësaj rregullore përcakton se “1. Komentet e marra gjatë procesit të konsultimit publik grumbullohen nga zyrtari përgjegjës në një mënyrë të strukturuar dhe transparente. 2. Shqyrtimi i komenteve bëhet nga organi propozues i projektaktit. Organi propozues vendos për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve të marra nga palët e interesuara”. Ndërsa, paragrafi 4 i këtij neni përcakton se “Raporti përfundimtar i konsultimit me publikun duhet të përmbaj të dhënat nga procesi i konsultimit duke u mbështetur në komentet e pranuar dhe adresimin e tyre. Raporti përgatitet në formën siç përcaktohet me Rregulloren e Punës së Qeverisë”. Lidhur me këtë projektligj, Ministria e Drejtësisë nuk ka publikuar fare raport të konsultimeve publike.

Krahas kësaj, kjo mënyrë e veprimit paraqet një nguti të paarsyeshme të Ministrisë së Drejtësisë, e cila nguti paraqet edhe mos interesim për të adresuar sfidat reale të llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas LPDGjP.

Këtë mënyrë të veprimit, në MD e kanë arsyetuar me faktin se LPDGjP ka një periudhë relativisht të shkurtër prej kur ka hyrë në fuqi. “Duke pasur parasysh se ishte periudhë relativisht e shkurtër që kishte hyrë ligji në fuqi grupi punues ishte pajtuar se në këtë fazë ishte e nevojshme që të evitohet sa më shpejtë ky lëshim, dhe të mos shkohet më tej me ndryshime të ligjit, pra ndryshimet të kufizohen vetë sa i përket nenit 12, paragrafit 9 të Ligjit pasi që çdo thellim përtej përmirësimit teknik në nenin 12, sipas grupit punues, do i bënte dëm procedurës së disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve duke sjellë shumë vonesa dhe mangësi në ofrimin e drejtësisë” thuhet në komentet e MD mbi këtë raport. Sipas MD, rishikimi i tërësishëm i këtij ligji do të bëhet pas përfundimit të disa proceseve në MD, siç janë Rishikimi Funkcional i Sektorit të Sundimit të Ligjit, Vetingu etj. Sa i përket konsultimeve publike, MD ka treguar se këtë projektligj e ka publikuar për konsultime publike, por se nuk ka dhënë përgjigje se pse nuk është publikuar raporti përfundimtar në të cilin jepen edhe arsytet e refuzimit të komenteve të pranuar<sup>37</sup>.

---

<sup>37</sup> Komentet e MD për draftin e raportit të llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve. 24 shtator 2021.

## 8. Rekomandime

- Autoritetet kompetente mos të kalojnë nivelin e kompetencës së tyre për të vlerësuar meritat e ankesës disiplinore, por të kufizohen në vlerësimin nëse një ankesë disiplinore përbën “çështje disiplinore”.
- Autoritetet kompetente të japin arsyetime meritore në vendimet e tyre lidhur me ankesat disiplinore.
- Autoritetet kompetente të vendosin brenda afateve ligjore.
- Autoritetet kompetente që nuk vendosin brenda afateve ligjore, mos të amnistohen nga KPK.
- Këshillat të mbajnë përgjegjës autoritetet kompetente, veçanërisht në rastin e nxjerrjes së vendimeve mbi bazën e gabimeve të qarta profesionale.
- Me rastin e shqyrtimit të gjendjes faktike të një rasti disiplinor, KGJK të trajtojë gjendjen faktike sipas gjithë dokumentacionit dhe mos të fokusohet vetëm në dokumentet apo provat e tjera të cilat shkojnë në favor të vetëm njëres palë.
- KGJK përmes lirimit të gjyqtarëve nga përgjegjësia disiplinore mos të lejojë normalizimin e praktikave të cilat cenojnë dinjitetin dhe profesionalizmin e sistemit gjyqësor.
- Kryeprokurorët mos të aplikojnë qasje selektive në raport me trajtimin e ankesave disiplinore.
- NjIGj dhe NjShPP të hulumtojnë arsyet e numrit të madh të ankesave disiplinore të cilat hudhen nga autoritetet kompetente dhe gjetjet ti prezantoj tek këshilli përkatës.
- Avokati i Popullit të kuptojë rolin e tij në sistemin e llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke vendosur si në rastet kur autoritetet kompetente nuk kanë nxjerrë vendime brenda afatit të përcaktuar me ligj ashtu edhe në rastet kur autoritetet kompetente kanë hedhur ankesat disiplinore dhe Avokati i Popullit gjen se ankesa disiplinore nuk do duhej hedhur.
- Avokati i Popullit të ushtrojë ankesa në Gjykatën Supreme ndaj vendimeve të KPK-së, në rastet kur Avokati i Popullit është parashtrues i kërkesës për fillimin e hetimeve disiplinore.
- Ministria e Drejtësisë të zbatojë Rregulloren (QRK) Nr.05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik.
- Ministria e Drejtësisë mos të shpërfillë komentet e publikut dhe shoqërisë civile.
- Ministria e Drejtësisë të adresojë të gjitha sfidat në zbatimin praktik të LPDGjP.

## 9. Shtojca 1: Ankesat disiplinore të iniciuara nga IKD

Gjatë vitit 2020 dhe 2021, IKD ka parashtruar gjithsej 16 ankesa disiplinore ndaj prokurorëve. 13 prej tyre janë refuzuar nga autoritetet kompetente ndërsa dy (2) janë aprovuar nga autoritetet kompetente. Njëri prej këtyre dy (2) rasteve, ka përfunduar me masë disiplinore nga KPK. Në njërin rast, autoriteti kompetent nuk ka kthyer fare përgjigje.

Në tabelën në vijim, IKD ka paraqitur në mënyrë të detajuar rastet e iniciuara disiplinore ndaj prokurorëve, ku përfshihet edhe data e shkeljes së supozuar disiplinore, lloji i shkeljes së supozuar disiplinore dhe vendimet e marra nga AK përkatëse dhe KPK.

Prokurori ndaj të cilit është iniciuar ankesa disiplinore	Data e shkeljes së supozuar disiplinore	Lloji i shkeljes së supozuar disiplinore	AK/Vendimi	KPK
<b>F.F.</b>	29.06.2015; 02.03.2019 deri më 29.09.2019	Cenim i të drejtave së të pandehurit/cenim i parimit të ekonomizimit të procedurës penale.	Kryeprokurori i PSRK  Refuzim i ankesës disiplinore	/
<b>H.J.</b>	22.08.2019	Mos respektim i autoritetit të gjykatës/ shkelje të Kodit të Etikës dhe Sjelljes për prokurorë	Kryeprokurori i PTh Gjilan  Aprovues(Kërkesë për fillim të hetimit disiplinor)	Lirim nga përgjegjësia disiplinore
<b>B.M.</b>	30.09.2019	Cenim i sigurisë juridike/të drejtave të pandehurve	Kryeprokurori i PTh Prishtinë  Refuzim i ankesës disiplinore	/
<b>R.L. dhe A.A.</b>	20.07.2016 dhe 23.04.2019	Cenim i sigurisë juridike/të drejtave të pandehurve	Kryeprokurori i PTh Prishtinë	/

			Autoriteti kompetent nuk ka nxjerrë vendim	
<b>L.V dhe S.M.</b>	25.10.2016 e deri me 05 06.2019	Cenim i të drejtave pandehurve	Kryeprokurori i PTh Pejë  Refuzim i ankesës disiplinore	/
<b>F.S.</b>	14.01.2020	Cenim i sigurisë juridike/të drejtave pandehurve	Kryeprokurori i PTh Prishtinë  Aprovim i ankesës disiplinore (Kërkesë për fillim të hetimit disiplinor)	Masë disiplinore
<b>D.H.</b>	10.01.2020	Komentimi i vendimeve gjyqësore/Shkeljetë Kodit të Etikës dhe Sjelljes për prokurorë	Kryeprokurori i PSRK  Refuzim i ankesës disiplinore	/
<b>Rr.P.</b>	10.02.2020	Cenim i sigurisë juridike/të drejtave pandehurve	Kryeprokurori i PTh Prishtinë  Refuzim i ankesës disiplinore	/
<b>J.P.</b>	14.02.2020	Cenim i sigurisë juridike/të drejtave pandehurve	Kryeprokurori i PTh Prishtinë  Refuzim i ankesës disiplinore	/
<b>H.K.</b>	23.01.2020	Mos përfaqësim i duhur i aktakuzës	Kryeprokurori i PTh Prishtinë  Refuzim i ankesës disiplinore	/

<b>F.B.</b>	22.09.2020	Mos përfaqësim i duhur i aktakuzës/Cenim i të drejtave të të dëmtuarit	Kryeprokurori i PTh Prishtinë Refuzim i ankesës disiplinore	/
<b>F.B.</b>	27.01.2020	Cenim i sigurisë juridike/të drejtave të pandehurve	Kryeprokurori i PTh Prishtinë Refuzim i ankesës disiplinore	/
<b>H.S.</b>	12.03.2020	Cenim i të drejtave të pandehurve	Kryeprokurori i PSRK Refuzim i ankesës disiplinore	/
<b>F.C., E.B. dhe M.K.</b>	19.10.2020	Cenim i të drejtave të pandehurve	Kryeprokurori i PTh Prishtinë Refuzim i ankesës disiplinore	/
<b>B.J.</b>	23.11.2020	Cënim i sigurisë juridike/të drejtave të pandehurve	Kryeprokurori i PTh Prishtinë Refuzim i ankesës disiplinore	/
<b>F.S.</b>	23.11.2020	Cenim i sigurisë juridike/të drejtave të pandehurve	Kryeprokurori i PTh Prishtinë Refuzim i ankesës disiplinore	/

**Tabela 3: Ankesat disiplinore ndaj prokurorëve të parashtruara nga IKD dhe BpD.**

Në anën tjetër, gjatë vitit 2020 dhe 2021, IKD ka parashtruar gjithsej tetë (8) ankesa disiplinore ndaj gjyqtarëve. Katër (4) prej tyre janë refuzuar, derisa katër (4) të tjera janë aprovuar nga autoritetet kompetente. Në të gjitha ankesat disiplinore të aprovuara nga autoritetet kompetente, KGJK ka liruar gjyqtarët nga përgjegjësia disiplinore.



Në tabelën në vijim, IKD ka paraqitur në mënyrë të detajuar rastet e iniciuara disiplinore ndaj prokurorëve, ku përfshihet edhe data e shkeljes së supozuar disiplinore, lloji i shkeljes së supozuar disiplinore dhe vendimet e marra nga autoritetet përkatëse:

Gjyqtari ndaj të cilit është iniciuar ankesa disiplinore	Data e shkeljes së supozuar disiplinore	Natyre e shkeljes së supozuar disiplinore	AK/Vendimi së	KGJK
<b>V.I., N.K.-J. dhe N.K.-M.</b>	09.12.2019	Dështim mbajtjes rendit gjykatore	i së në Kryetarja e GjTh Prishtinë Aprovues(Kërkesë për fillim të hetimit disiplinor)	Lirim nga përgjegjësia disiplinore
<b>V.I., N.K.-M.; N.K- J.; A.K. dhe K.K.</b>	05.12.2019 dhe 09.12.2019	Mbyllje e kundërligjshme e seancës	Kryetarja e GjTh Prishtinë Refuzim i ankesës disiplinore	
<b>A.A.; T.B.; Xh.A.</b>	8.1.2019	Cenim i të drejtave të pandehurit	Kryetari i GjA Aprovues(Kërkesë për fillim të hetimit disiplinor)	Lirim nga përgjegjësia disiplinore
<b>S.Sh.</b>	04.07.2019; 23.07.2019; 24.07.2019; 25.07.2019; 26.07.2019	Mbyllje e kundërligjshme e seancës	Kryetari i GjS Refuzim i ankesës disiplinore	/
<b>F.Z.</b>	03.07.2017; 28.08.2018 deri më 05.06.2019	Cenim i të drejtave të pandehurit	U.d. Kryetari i GjTh Pejë Refuzim i ankesës disiplinore	/

<b>Sh.B.</b>	14.1.2020	Cenim i të drejtave së të pandehurit	Kryetarja e GjTh Prishtinë  Aprovues(Kërkesë për fillim të hetimit disiplinor)	Lirim nga përgjegjësia disiplinore
<b>H.B.</b>	4.2.2020	Shkelje e ligjit	Kryetarja e GjTh Prishtinë  Aprovues(Kërkesë për fillim të hetimit disiplinor)	Lirim nga përgjegjësia disiplinore
<b>A.H.</b>	12.03.2020	Cenim i të drejtave të pandehurve	Kryetarja e GjTh Prishtinë  Refuzim i ankesës disiplinore	/

**Tabela 4: Ankesat disiplinore ndaj gjyqtarëve të parashtruara nga IKD dhe BpD.**